

Sistemi i Numrit Standard Ndërkombëtar të Librit

DORACAK I ISBN-së

Botimi ndërkombëtar
Ribotimi i gjashtë

Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së
Londër, 2012

Versionin më të ri të *Doracakut të ISBN-së* mund ta gjeni në ueb-sajtin e Agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-së:
<http://www.isbn-international.org>

©2012 nga Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së, Londër, UK
Ribotimi i gjashtë
Agjencia jep leje për ribotimin e çfarëdo materiali në këtë broshurë me kusht që të citohet burimi, si dhe një kopje, mundësisht në formatin elektronik, t'i dërgohet Agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-së.

Të drejtat ekskluzive të përkthimit dhe të botimit në gjuhën shqipe për Kosovë i përkasin Agjencisë Kombëtare të ISBN-së të Republikës së Kosovës

Adresa: Sheshi "Hasan Prishtina", p.n. Prishtinë
www.biblioteka-ks.org

PËRMBAJTJA

1. Informacion i përgjithshëm	5
2. Dohitë e ISBN-së	6
3. Funksioni dhe fushëveprimi i ISBN-së	8
4. Struktura e ISBN-së	11
4.1. Elementi i prefiksit	12
4.2. Elementi i grupit	12
4.3. Elementi i botuesit	13
4.4. Elementi i botimit	13
4.5. Shifra e kontrollit	14
5. Aplikimi i ISBN-së	14
5.1. Informacione të përgjithshme	14
5.2. Ndryshimet në botime	14
5.3. Riprodhimi i faksimileve	15
5.4. Botimet në forma të ndryshme të produktit	15
5.5. Botimet e palidhura	15
5.6. Botimet shumëvëllimëshe	16
5.7. Lista e botimeve të mëparshme	16
5.8. Botimet si rezultat i bashkëpunimit	16
5.9. Botimet që shiten ose shpërndahen prej agjentëve	17
5.10. Blerja e një botuesi nga një tjetër	17
5.11. Blerja e stoqeve komplete dhe e të drejtave të një botimi	18
5.12. Botuesit me më shumë se një vend të botimit	18
5.13. Regjistrimi i ISBN-ve dhe i metadatave shoqëruese	18
5.14 .Numrat e ISBN-ve nuk mund të përdoren dy herë	20
6. ISBN-ja për botimet elektronike dhe softuerët edukativo-arsimor	20
6.1. ISBN-ja për botimet elektronike që i plotësojnë kriteret	20
6.2. ISBN-ja për produktet softuerike që i plotësojnë kriteret	21
6.3. Parimet për caktimin e ISBN-së për botimet elektronike dhe produktet softuerike që i plotësojnë kriteret	21
7. ISBN-ja për botimet që shtypen sipas kërkesës	26

8. Vendi dhe dukja e ISBN-së në botime	27
8.1. Informacion i përgjithshëm	27
8.2. ISBN-ja në formën e barkodit	29
8.3. Numri i shtuar pesëshifrorë në kod	30
8.4. Algoritmi për gjenerimin e ISBN-së dhe barkodit EAN.UCC	30
9. Administrimi i sistemit të ISBN-së	31
9.1. Informacione të përgjithshme	31
9.2. Administrimi ndërkombëtar	31
9.3. Agjencitë kombëtare/rajonale/gjuhësore të ISBN-së	32
9.4. Administrimi nga botuesi	34
10. Botuesit mospjesëmarrës	35
11. ISBN-ja dhe GS1	36
12. ISBN-ja dhe identifikuesit e tjerë	36
12.1. DOI	36
12.2. ISBN-A	37
12.3. GTIN	37
12.4. URN	38
12.5. ISAN	39
12.6. ISMN	39
12.7. ISRC	40
12.8. ISSN	41
12.9. ISTC	41
12.10. ISWC	42
12.11. ISNI	43
13. ONIX për libra	44
14. Botimet	45
15. Pyetjet e shpeshta lidhur me sistemin e ISBN-së	46
Shtojca 1.: Llogaritja e shifrës së kontrollit dhe përndarja e serisë së numrave të ISBN-së	47
A1.1. Llogaritja e shifrës së kontrollit	47
A1.2. Përndarja e serisë së numrave të ISBN-së	48

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Në Konferencën e tretë ndërkombëtare për *Hulumtimin e tregut të librit dhe racionalizimit në tregun e librit*, të mbajtur në nëntor të vitit 1966 në Berlin, u diskutua për herë të parë mundësia dhe nevoja për një sistem ndërkombëtar të numërimit të librit.

Atëkohë, një numër i botuesve evropianë dhe të shpërndarësve të librit po e konsideronin shfrytëzimin e kompjuterëve për përpunimin e porosive dhe për inventarizimin e tyre. Si rrjedhojë u bë më se e qartë nevoja e një numri unik dhe të thjeshtë për identifikimin e një titulli të botuar si parakusht i një sistemi efikas të automatizuar.

Ky sistem që e plotësonte këtë parakusht dhe i cili u bë i njohur me emrin sistemi i *Numrit Standard Ndërkombëtar të Librit (ISBN)* u zhvillua dhe buroi prej sistemit të numërimit të librit i përdorur në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 1967 nga J. Whitaker & Sons, Ltd., si dhe në Shtetet e Bashkuara në vitin 1968 nga R. R. Bowker.

Në të njëjtën kohë, *Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO)* me *Komitetin e saj teknik 46 për informacionin dhe dokumentimin*, e themeloi një grup punues për hulumtimin e mundësive të përshtatjes së sistemit britanik për shfrytëzim ndërkombëtar.

Gjatë vitit 1968 dhe 1969 u mbajtën disa takime midis përfaqësuesve nga vendet e ndryshme evropiane dhe të Shteteve të Bashkuara, dhe se ai raport iu dërgua të gjitha vendeve që ishin pjesë e ISO-s.

Si rezultat i këtyre takimeve, u miratua *Numri Standard Ndërkombëtar i Librit (ISBN)* si standardi 2108¹ i ISO-s në vitin 1970.

¹ Standardi mund të merret nga organizatat kombëtare të standardeve.

Ribotimi i tretë i këtij standardi në vitin 1992 e zëvendësoi ribotimin e dytë të vitit 1978.

Qëllimi i këtij standardi ndërkombëtar është standardizimi dhe bashkërendimi i shfrytëzimit në nivel ndërkombëtar i numrave të ISBN-së që të mundësojë identifikimin unik të një botimi ose ribotimi të një botuesi të caktuar dhe në një format të caktuar.

Standardi origjinal ka marrë formën e librit, dhe se botimet në këtë formë kanë filluar të shfaqen edhe në formate të reja. Sot për sot, ky sistem përdoret në mbi 160 shtete të botës.

Në vitin 2001 u formua një grup punues për ta rishikuar standardin dhe për ta përgatitur ribotimin e tij të katërt. Kjo bëri që gjatësia e numrit të ISBN-së të rritet nga 10 në 13 shifra, duke përfshirë edhe 3 shifrat paraprijëse të ofruara nga GS1 (e njohur më parë si "EAN International dhe Uniform Code Council"). Si rrjedhojë u rrit edhe kapaciteti i numërimit të sistemit dhe u bë kompatibil me GS1 GTIN-13 (shih seksionin 11). Gjithashtu, versioni i ri i standardit i specifikonte metadatat që duhej ta shoqëronin dhënien e ISBN-së, i përcaktonte rregullat për administrimin dhe qeverisjen e sistemit, si dhe e specifikonte autoritetin regjistruar për këtë standard.

Ky doracak shpjegon funksionimin e sistemit dhe hapat e nevojshëm në mënyrë që numri i ISBN-së të jepet me saktësi. Po ashtu, doracaku ofron udhëzime të veçanta sa i përket dhënies së numrave të ISBN-së për botimet digjitale.

2. DOBITË E ISBN-së

- ISBN-ja është identifikues unik ndërkombëtar për botimet monografike; caktimi i një numri të tillë, zëvendëson përdorimin e përshkrimeve të gjata bibliografike, duke kursyer kohën dhe mundin e stafit, si dhe zvogëlon mundësinë e gabimeve.

- Përdorimi i saktë i ISBN-së mundëson dallimin e qartë të formave dhe ribotimeve të ndryshme të një libri, pa marrë parasysh nëse është i shtypur apo digjital, duke siguruar në këtë mënyrë që klienti ta marrë versionin që kërkon.
- ISBN-ja mundëson përpilimin dhe përditësimin e direktorimeve për tregtimin e librit dhe të bazave bibliografike të të dhënave, si katalogët e librave në shtyp. Me të mund të gjinden me lehtësi informatat lidhur me librat që janë në dispozicion.
- Porosia dhe shpërndarja e librave kryesisht bëhet përmes shfrytëzimit të numrit të ISBN-së, pasi është metodë më e shpejtë dhe më efikase.
- ISBN-ja lexohet prej kompjuterit dhe ka formën e një numri dhe barkodi 13-shifrorë (EAN-13). Është mënyrë e shpejtë dhe i shmagngabimet.
- ISBN-ja është e domosdoshme në menaxhimin e sistemeve elektronike të shitjes nëpër librari.
- Shumë sisteme të veprimtarive botuese dhe të furnizimit bazohen në ISBN.
- Grumbullimi i informatave të shitjes bëhet përmes ISBN-së. kjo mundëson monitorimin e suksesit të formateve dhe ribotimeve të ndryshme të produkteve, si dhe lehtëson krahasimin mes lëmenjve të ndryshëm, madje edhe mes shtëpive të ndryshme botuese.
- Në disa shtete e drejta kombëtare për të huazuar bazohet gjithashtu në sistemin e ISBN-së. Skemat e tilla u mundësojnë autorëve dhe ilustruesve që të paguhen në përpjesëtim me atë se sa herë u janë huazuar librat nëpër bibliotekat publike.

3. FUNKSIONI DHE FUSHËVEPRIMI I ISBN-së

I pranuar prej më shumë se 160 shteteve të mbarë botës, *Numri Standard Ndërkombëtar i Librit* është identifikues i shkurtër dhe i qartë që mund të lexohet edhe përmes pajisjeve teknologjike. ISBN-ja e shënjon një botim monografik në mënyrë unike dhe duhet ta shoqërojë atë që në fazat e hershme të fillimit të procesit të botimit. ISBN-ja është një instrument i rëndësishëm në procesin e botimit, të shpërndarjes, të analizave të shitjes, dhe për sistemet e ruajtjes së të dhënave bibliografike në tregtinë e librit. Si i tillë, numri i ISBN-së ka po aq rëndësi edhe në menaxhimin e informacionit në biblioteka.

Megjithatë, kur një produkt kualifikohet për një sistem tjetër të numërimit (si burimet e vazhdueshme dhe ato të integruara, që pasojnë njëra pas tjetrës, e që kualifikohen për ISSN, si dhe muzika e shtypur që kualifikohet për ISMN), atëherë duhet të përdoret ai sistem. Po qe se është e mundur, identifikuesit e tillë duhet të përdoren në shoqërim me ISBN-në. Seksioni 12 ofron më shumë informata lidhur me llojet e identifikuesve të tjerë.

Numrat e ISBN-ve u caktohen botimeve monografike, duke përfshirë produktet e ngjashme si botimet në formë kompletesh ose seri të kompletuara e që janë në dispozicion të publikut, dhe pa marrë parasysh nëse ato botime dhe produkte të ngjashme ofrohen falas apo blihen. Përveç kësaj, identifikuesi i ISBN-së mund t'u caktohet edhe seksioneve të veçanta (si kapitujve) të botimeve monografike, apo edhe botimeve të veçanta të numrave apo artikujve të burimeve të vazhdueshme. Nëse botimi kualifikohet për numër të ISBN-së, atëherë nuk përbën ndonjë rëndësi të madhe se në çfarë forme fizike dokumentohet ose shpërndahet përmbajtja e tij; megjithatë, secila formë e produktit duhet të identifikohet veç e veç.

Shembuj të llojeve të botimeve monografike, të cilave duhet t'u caktohet numri i ISBN-së, përfshijnë:

- Librat e shtypur dhe pamfletet;
- Botimet në braj;
- Botimet të cilat botuesi nuk ka për qëllim t'i përditësojë rregullisht apo t'i botojë për kohë të pacaktuar;
- Artikujt² apo numrat individualë të një burimi të caktuar të vazhdueshëm (por jo burimit të vazhdueshëm si tërësi);
- Hartat;
- Filmat për qëllime arsimore/instruksione, videot dhe diapozitivat;
- Audio-librat në kasete, ose CD, ose DVD (libra me zë);
- Botimet elektronike ose në bartësin e tyre fizik (si në shirita që lexohen nga pajisjet teknologjike, disketa, ose CD-ROM) ose në internet (për shkarkim apo qasje direkte onlajn);
- Kopjet e digjitalizuar të botimeve të shtypura monografike;
- Botimet në mikroforma;
- Softuerët për çështje arsimore apo instruksione;
- Botimet në formate të ndryshme (kur përbërja kryesore është në formë teksti).

Disa shembuj të llojeve të materialeve, të cilave nuk duhet t'u caktohet numri i ISBN-së, përfshijnë:

- Burimet e vazhdueshme³ në formën e tyre të plotë si entitet bibliografik (numra të caktuar mund të kualifikohen për numra të ISBN-së);

²Kur artikuj individualë ofrohen si të veçuar nga botuesi, ata kualifikohen si botime monografike dhe duhet t'u caktohet një numër i ISBN-së. Kjo nuk zbatohet në rastin e kopjeve offprint ose preprint që porositen prej autorit (autorëve) të një artikulli për qëllime të veta të shpërndarjes.

³Një botim që botohet për një kohë pa një datë të caktuar të përfundimit. Një botim i tillë zakonisht del në botim si numra të një pasnjëshëm ose i integruar, që në përgjithësi kanë një identifikim numerik dhe/ose kronologjik. Shembuj tipikë të këtyre përfshijnë botimet serike, si: gazetatat, periodikët, revistat, magazinat, etj., dhe burimet e integruara si botimet e palidhura me qëllim të përditësimit të materialit dhe uebsajtet që përditësohen.

- Entitetet abstrakte⁴ si vepra tekstuale dhe krijime të tjera abstrakte me përmbajta intelektuale ose artistike;
- Materialet e shtypura të imta, si shpallje dhe të ngjashme;
- Muzika e shtypur (partiturat);
- Veprat e shtypura të artit dhe folderë arti pa faqe të titullit dhe tekst;
- Dokumentet personale (si biografi elektronike apo profil personal);
- Kartolinat përshëndetëse;
- Incizimet zanore të muzikës;
- Softuerët për qëllime të tjera, përveç atyre për arsim dhe instruksione;
- Tabelat elektronike për informata;
- E-mailat dhe korrespondencat e tjera elektronike;
- Lojërat.

Kur një produkt vihet në dispozicion dhe shoqërohet prej një ekzemplari dytësor që nuk kualifikohet vetë për ISBN, atëherë duhet të përdoret vetëm një ISBN për t'i identifikuar ekzemplarët e kombinuar, dhe një ISBN tjetër për ta identifikuar produktin që kualifikohet për ISBN, nëse ofrohet në dispozicion si i veçuar. Megjithatë, pasi është jashtë fushëveprimit të ISBN-së, ajo nuk do të përdoret për t'i identifikuar elementet dytësorë, nëse vihen në dispozicion si të veçuara.

Disa identifikues, si: ISSN-ja dhe ISMN-ja, kanë rregulla të sakta sa i përket fushëveprimit të materialeve që kualifikohen për caktimin e identifikuesve, ndërsa disa identifikues të tjerë, si GTIN-13 për produkte tregtare, mund të përdoret te produkte të ndryshme.

Meqë ISBN-ja tani është në harmoni të plotë me GTIN-13, kjo e bën edhe më të përshtatshëm për shitësit me pakicë që t'i shesin

⁴Për shembull, secila formë e një produkti të veçantë të romanit "Plaku dhe deti" kualifikohet për një numër të ISBN-së, por vetë romani, si vepër abstrakte tekstuale, nuk merr ISBN.

produktet me interes të përbashkët, dhe që nuk kualifikohen për ISBN, por të cilët e përdorin GTIN-13 në vend të tij, pa pasur ndonjë nevojë që t'i përshtatin sistemet e tyre.

Për të marrë informata të mëtejme, përfshirë edhe shpjegimet nëse një produkt i caktuar kualifikohet ose jo për ISBN, ju lutem ta kontaktoni agjencinë kombëtare për regjistrimin e ISBN-së në shtetin tuaj. Për t'u njoftuar me llojet e tjerë të identifikuesve dhe aplikimin e tyre, ju lutem konsultojeni **Seksionin 12 - ISBN-ja dhe identifikuesit e tjerë**.

4. STRUKTURA E ISBN-së

Prej 1 janarit të vitit 2007, agjencitë kombëtare të ISBN-së lëshojnë numra të ISBN-së që janë 13 shifrorë dhe përbëhen prej këtyre elementeve:

- Elementi i prefiksit
- Elementi i grupit
- Elementi i botuesit
- Elementi i botimit
- Shifra e kontrollit

Me rastin e shtypjes, numrit të ISBN-së i paraprijnë gjithmonë shkronjat "ISBN".

Vërejtje: Në vendet ku nuk përdoret alfabeti latin përveç shkronjave latine "ISBN" mund të përdoret edhe ndonjë shkurtesë në alfabetin e atij vendi.

ISBN-ja ndahet në pesë elemente, tri prej tyre kanë gjatësi të ndryshueshme; elementi i parë dhe i fundit kanë gjatësi fikse. Elementet duhet të ndahen qartë me vizë lidhëse ose hapësirë kur të paraqiten në formën që e lexon syri i *njeriut*.

ISBN 978-0-571-08989-5

ose

ISBN 978 0 571 08989 5

Vërejtje: Përdorimi i vizave lidhëse ose i hapësirave nuk ka ndonjë domethënie leksikore, dhe ka për qëllim që ta bëjë leximin e numrave më të lehtë.

Numri i shifrave tek elementi i dytë, i tretë, dhe i katërt i ISBN-së ndryshon (d.m.th. elementi i grupit, elementi i botuesit, elementi i botimit). Gjatësia e elementit të grupit dhe e elementit të botuesit përkon me vlerësimin se sa do të jetë kontributi në botime të elementit të grupit ose i botuesit. Kur këta elementë janë të shkurtër, kjo tregon se produktiviteti i elementit të grupit ose i botuesit (ose i të dyve së bashku) pritet të jetë i madh sa i përket numrit të botimeve.

4.1. Elementi i prefiksit

Elementi i parë i ISBN-së është një numër treshifrorë që vjen prej GS1, i njohur më parë si numri ndërkombëtar EAN. Prefikset që vijnë prej GS1 janë 978 dhe 979, porse mund të caktohen edhe prefikse të tjerë në të ardhmen me qëllim që të sigurohen kapacitete të plota të sistemit të ISBN-së.

SHEMBULL: 978

4.2. Elementi i grupit

Elementi i dytë i ISBN-së e identifikon vendin, rajonin gjeografik, ose zonën gjuhësore të anëtarëve në sistemin e ISBN-së. Disa prej anëtarëve të sistemit të ISBN-së formojnë zona gjuhësore (p.sh., numri i grupit 3 = grupi i gjuhëve gjermane brenda elementit të prefiksit 978); të tjerët formojnë njësi rajonale (p.sh., numri i grupit 982 = Paqësori Jugor brenda elementit të prefiksit

978). Gjatësia e këtij elementi ndryshon, por mund të ketë deri në 5 shifra.

Elementet e grupit caktohen prej Agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-së.

SHEMBULL: 978-0

4.3. Elementi i botuesit

Elementi i tretë i ISBN-së e identifikon botuesin e caktuar apo shtypshkronjën brenda një grupi. Gjatësia e këtij elementi varet krejtësisht nga kontributi i paraparë i botimeve të botuesit, dhe mund të jetë i gjatë deri në 7 shifra. Botuesit që pritet të kenë produktivitet të lartë u caktohen elementet më të shkurtra të botuesit dhe anasjelltas.

I interesuari aplikon te agjencia e ISBN-së, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e sistemit të ISBN-së brenda atij vendi, rajoni apo grupi gjuhësor, ku i caktohet elementi i botuesit që është unik. Pasi të jenë harxhuar të gjithë numrat e mundshëm të ISBN-së që lidhen me elementin e botuesit, atëherë mund të caktohen elemente shtesë për atë botues, i cili mundëson caktimin e më shumë numrave të ISBN-së.

SHEMBULL: 978-0-11

4.4. Elementi i botimit

Elementi i katërt i ISBN-së e identifikon një ribotim të caktuar të një titulli të një botuesi. Gjatësia e këtij elementi ndryshon varësisht prej asaj se sa pritet të botojë botuesi në fjalë dhe mund të ketë deri në 6 shifra. Botuesve me sasi të madhe të botimit të titujve u caktohen elementet më të gjata të botimit dhe anasjelltas. Për t'u siguruar që gjatësia e këtij elementi të ISBN-së

të jetë e saktë, atëherë numrit i paraprijnë shifra të zbrazëta me vlerën zero.

SHEMBULL: 978-0-11-000222

4.5. Shifra e kontrollit

Elementi i pestë i ISBN-së është shifra e kontrollit. Kjo shifër llogaritet duke përdorur algoritmin me faktorin 10. (Shih shtojcën 1 për metodën e përlllogaritjes ose informacionin kontaktues të agjencisë kombëtare për të marrë më shumë këshilla).

▶▶▶ 5. APLIKIMI I ISBN-së

5.1. Informacione të përgjithshme

Secilit botim të veçantë monografik duhet t'i caktohet nga një numër i veçantë i ISBN-së, apo secilit ribotim ose format të veçantë të botimit monografik që botohet nga ai botues. Duhet t'i caktohet një numër i veçantë i ISBN-së edhe secilit ribotim në gjuhë të ndryshme të një botimi monografik.

5.2. Ndryshimet në botime

Duhet të caktohet numër i veçantë i ISBN-së nëse ka ndryshime të dukshme në cilëndo pjesë të një botimi. Duhet të caktohet numër i veçantë i ISBN-së nëse ka ndryshim të titullit dhe/ose nëntitullit të botimit. Ndryshimi i dizajnit të kopertinës ose ngjyrave ose i çmimit të një botimi monografik, nuk kërkon numër të veçantë të ISBN-së. Ndryshimet e vogla në ndonjë ribotim (p.sh. përmirësime të gabimeve të shtypit) nuk kërkojnë numër të veçantë të ISBN-së.

5.3. Riprodhimi i faksimileve

Duhet t'i caktohet një numër i veçantë i ISBN-së secilës faksimile që prodhohet nga një botues ose ribotohet me kredencialet e një botuesi tjetër. Po ashtu i caktohet ISBN e veçantë nëse botimi i njëjtë botohet nga e njëjta shtëpi botuese por me emër tjetër të shtëpisë botuese. Nëse një libër është skanuar dhe është digjitalizuar nga një organizatë, jo prej botuesit origjinal (p.sh. nga një bibliotekë), atëherë versioni i skanuar dhe i digjitalizuar duhet të marrë ISBN të veçantë për prodhuesin e ri me kusht që ai version të jetë në dispozicion të publikut (për dallim prej qëllimeve krejtësisht arkivore).

5.4. Botimet në forma të ndryshme të produktit

Forma të ndryshme të një botimi (p.sh. me kopertina të forta, me kopertina të buta, në alfabetin braj, audio-libra, botime elektronike në internet) kërkojnë që të gjitha numra të veçantë të ISBN-së. Në rastin kur ka në dispozicion botime elektronike në formate të ndryshme të fajllave, atëherë *secilit format në dispozicion* duhet t'i caktohet një ISBN unike. (Shih seksionin 6.3 për informata më të detajuara sa i përket menaxhimit me formate të fajllave të librave elektronikë).

5.5. Botimet e palidhura

ISBN-ja duhet t'i caktohet një botimi të palidhur që përditësohet për një kohë të caktuar – d.m.th. botimet e palidhura që nuk kanë për qëllim të vazhdojnë pafundësisht.

ISBN-ja nuk duhet t'u caktohet botimeve të palidhura që përditësohen vazhdimisht (burimeve të integruara) apo seksioneve të veçanta të përditësuara.

5.6. Botimet shumëvëllimëshe

Botimet mund të përbëhen prej më shumë se një vëllimi, dhe në këto raste duhet të caktohet një numër i ISBN-së për ta mbuluar tërë kompletin. Nëse ofrohen në dispozicion vëllime të veçanta të kompletit, atëherë secili vëllim duhet të ketë nga një numër unik të ISBN-së për ta identifikuar atë vëllim të veçantë. Faqja e prapme e faqes së titullit (apo një pozitë e barasvlershme me të për versionet që nuk shtypen) duhet qartë ta ketë të vënë, në secilin rast, numrin e ISBN-së për kompletin si tërësi si dhe numrin e ISBN-së për atë vëllim të veçantë.

Edhe nëse botimet shumëvëllimëshe ofrohen në dispozicion vetëm si komplet, përsëri rekomandohet që secili vëllim në atë komplet të ketë nga një numër të ISBN-së. Duke vepruar kështu, lehtësohen faza të ndryshme të transaksioneve, përfshirë çështjet e transportimit (dërgesave) me rastin kur jo të gjitha vëllimet e atij kompleti botohen apo shpërndahen në të njëjtën kohë, si dhe furnizimi me kopje zëvendësuese në rastin e kopjeve të dëmtuara.

5.7. Lista e botimeve të mëparshme

Një botues është i obliguar që t'i numërojë të gjitha botimet e mëparshme si dhe të shtypë numrat e ISBN-së në secilin katalog që e boton pa marrë parasysh nëse këta katalogë shtypen në formatin elektronik apo në letër.

5.8. Botimet si rezultat i bashkëpunimit

Botimet që dalin si botim i përbashkët me botues të tjerë zakonisht marrin një numër të ISBN-së të botuesit (botuesve) që është përgjegjës për shpërndarjen e tij. Megjithatë, lejohet që secili bashkë-botues t'ia vejë botimit numrin e vet të ISBN-së dhe që secili prej tyre të vendoset në faqen e mbrojtjes së të drejtave autoriale. Në raste të këtilla vetëm njëri prej numrave të ISBN-së duhet të përdoret si barkod i atij botimi.

5.9. Botimet që shiten ose shpërndahen prej agjentëve

(Më poshtë, b. dhe d. aplikohen vetëm për vendet që nuk janë pjesëmarrëse ende në sistem)

- a.** Siç thuhet në standardin e ISBN-së, një ribotim i caktuar i botuar nga një botues i caktuar merr vetëm një ISBN. Ky numër i ISBN-së duhet të mbetet i tillë pa marrë parasysh se ku, ose nga kush shpërndahet ose shitet botimi.
- b.** Një botimi të importuar nga një shpërndarës ekskluziv apo agjent i caktuar nga një zonë që ende nuk është në sistemin e ISBN-së dhe se nuk ka të ndarë numra të ISBN-së për të, atëherë mund t'i caktohet një ISBN nga shpërndarësi ekskluziv.
- c.** Botimet e importuara nga një shpërndarës ekskluziv apo agjent i caktuar, të cilave u është shtuar një faqe e titullit (që përmban kredencialet e shpërndarësit ekskluziv) në vend të faqes së titullit të botuesit origjinal, atëherë u caktohet një ISBN e re nga shpërndarësi ekskluziv apo agjenti i caktuar. Në këtë rast, duhet të vihet edhe ISBN-ja e botuesit origjinal.
- d.** Një botimi të importuar nga disa shpërndarës nga një zonë që nuk është ende në sistemin e ISBN-së, dhe se nuk ka ndonjë numër të caktuar të ISBN-së për të, atëherë mund t'i caktohet një ISBN nga grupi i agjencive, i cili është përgjegjës për këta shpërndarës.

5.10. Blerja e një botuesi nga një tjetër

Një botues që e blen një botues tjetër mund të vazhdojë t'i përdorë numrat e pashfrytëzuar të ISBN-ve nga elementi i botuesit origjinal. Agjencia kombëtare e ISBN-së, përgjegjëse për elementin e botuesit, duhet të informohet për pronësinë e bartur të elementit të botuesit.

5.11. Blerja e stokeve complete dhe e të drejtave të një botimi

Një botues, i cili e blen një stok komplet dhe të drejtat e një botimi (botimeve), mund të vazhdojë ta përdor numrin origjinal të ISBN-së derisa kompania e re t'i rishtypë ose t'i ribotojë botimet në kuadër të elementit të botuesit të kompanisë së vet.

5.12. Botuesit me më shumë se një vend të botimi

Një botues që vepron në disa shtete, të cilat renditen së bashku në një botim, atëherë atij botimit duhet t'i caktohet vetëm një ISBN.

Një botues që vepron ndarazi dhe ka zyra ose degë të veçanta (dhe që dallojnë mes veti) në shtete të ndryshme, mund të ketë element botuesi për secilën zyrë apo degë. Megjithatë, secilit botim duhet t'i caktohet vetëm një ISBN nga zyra ose dega përgjegjëse për atë botim.

5.13. Regjistrimi i ISBN-ve dhe i metadatave shoqëruese

Është përgjegjësi e botuesve që ta informojnë agjencinë e grupit të tyre, apo organizatën përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrimit të botimeve, sa i përket caktimit të numrave të ISBN-së që do t'u vendosen botimeve të ardhshme. Informacioni duhet të përfshijë disa të dhëna minimale të elementeve të metadatave (përshkruese), dhe se duhet të jenë në përputhje me standardet ONIX për informatat e librave që mirëmbahet nga EDItEUR dhe organizatat përkatëse të saj.

Elementi i të dhënave	Komente	ONIX – 3 elementësh
ISBN	Numër i ISBN-së në formatin 13 shifrorë, pa hapësira ose viza lidhëse.	<ProductIdentifier>
Forma e produktit	Kodim që e tregon mediumin dhe/ose formatin e produktit.	<ProductComposition> <ProductForm> <ProductFormDetail> <ProductPart>
	<i>Edhe pse nuk përmendet qartë në doracakun për përdorues të ISBN-së, masa fizike mund të dallojë mes dy produkteve fizike edhe pse me lidhje dhe format të njëjtë.</i>	<Measure>
	<i>Gjithashtu, për produktet digjitale, edhe kushtet e ndryshme të licencimit (që kushtëzojnë shfrytëzimin) apo specifikat e sistemeve operative mund të dallojnë mes dy produkteve, që përndryshe janë, identike.</i>	<ProductFormFeature> <EpubTechnicalProtection> <EpubUsageConstraint>
Titulli	Titulli i botimit, së bashku me nëntitullin ose elementet e tjera të titullit nëse ka.	<TitleDetail> composite
Seria	Titulli i serisë dhe numërimi kur ka.	<Collection> composite
Kontribuuesi	Kodi (kodet) i rolit të kontribuuesit dhe emri (emrat) i kontribuuesit.	<Contributor> composite [Identifier (ISNI) optional]
Ribotimi	Numri i ribotimit (për ribotimet pas atij të parit), lloji dhe elementet e ribotimit.	<EditionTypeCode> <EditionNumber> <EditionStatement>
Gjuha (gjuhët) e tekstit	Përdorimi i kodeve të gjuhëve ISO 639-2/B.	<Language> composite
Shtëpia botuese	Marka tregtare (brendi) nën të cilën është botuar botimi.	<Imprint> composite [Identifier (ISNI) optional]
Botuesi	Personi ose organizata që e zotëron shtypin në datën e botimit.	<Publisher> composite [Identifier (ISNI) optional]
	<i>Për produktet digjitale, ka dispozita që të bëhet e mundur caktimi i ISBN-së nga transmetuesi ndërmjetës nëse botuesi nuk e ka bërë një gjë të tillë.</i>	<RecordSource... elements
Vendi i botimit	Shfrytëzimi i kodeve të vendeve ISO 3166-1.	<CountryOfPublication>
Data e botimit	Data e botimit të parë në kuadër të këtij numri të ISBN-së. Në formatin ISO 8601 (VVVV-MM-DD).	<PublishingDate> composite [ONIX uses a format based on ISO 8601, YYYYMMDD]
ISBN-ja e botimit kryesor	ISBN-ja e botimit kryesor pjesë e të cilit është ky botim, nëse është i tillë. <i>Përdoret kur një ISBN është regjistruar për një kapitull ose pjesë – shih faqe 6.</i>	<RelatedProduct> composite <RelatedWork> composite

Vërejtje: Në disa raste paraqitja e metadatave të ISBN-së përmes ONIX bëhet me një kompozitë kur shihet se do të njaftonte në dukje të parë një element i thjeshtë i të dhënave, ose bëhet me një vlerë të koduar kur vlen vetëm një kod. Kjo qasje siguron që metadatat e ISBN-së të jenë të specifikuar në një mesazh të regjistrimit të ISBN-së në ONIX që është një lloj i elementeve në kuadër të ONIX-it për libra (ONIX 3.0).

Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së do ta ofrojë skemën në XML në rast kërkesë.

Bazat e të dhënave që i lidhin numrat e ISBN-së me metadatat e tyre (si listat e librave në shtyp e sipër, bibliografinë kombëtare, etj.) duhet të vihen në dispozicion dhe të përditësohen. Në rastet kur agjencitë e ISBN-ve nuk ofrojnë shërbime të tilla bibliografike, ato prapë se prapë janë përgjegjëse për të shërbyer si urë lidhëse me ofruesit e shërbimeve të tilla që të sigurohet qasje në ato shërbime. Kështu, konsumatorëve mund t'u kërkohej që t'i paguajnë agjencitë e ISBN-së dhe botuesit e bazave bibliografike për të pasur qasje në këtë informacion.

5.14. Numrat e ISBN-ve nuk mund të përdoren dy herë

Posa një numër i ISBN-së t'i caktohet një botimi monografik, ai nuk mund të përdoret më asnjëherë tjetër për ta identifikuar një botim tjetër monografik, edhe nëse ISBN-ja origjinale del se është caktuar gabimisht. Një botues, i cili zbulon se ISBN-ja është caktuar gabimisht duhet ta fshijë këtë numër nga lista e numrave që mund të përdoret. Botuesi duhet po ashtu ta raportojë ISBN-në e gabuar tek agjencia e tij e ISBN-së.

▶▶▶ 6. ISBN-ja PËR BOTIMET ELEKTRONIKE DHE SOFTUERËT EDUKATIV-ARSIMOR

6.1. ISBN-ja për botimet elektronike që i plotësojnë kriteret

Në rastin kur kemi një botim elektronik në dispozicion (p.sh. një libër elektronik, aplikacion libri elektronik, CD-ROM, ose botim në internet), ai do të kualifikohet për një ISBN me kusht që të përmbanë tekst dhe është në dispozicion të publikut, dhe se nuk ka qëllim të bëhet botim i formës së burimit/botimit të vazhdueshëm. Botimet e tilla mund të përfshijnë edhe fotografi dhe zë.

Llojeve në vijim të botimeve elektronike nuk duhet t'u caktohet numër i ISBN-së:

- Botimet që u nënshtrohen përditësimeve të shpeshta dhe ku qasja në këto ndryshime është gati e atypëratyshme, siç janë bazat onlajn të të dhënave;
- Ueb-sajtet;
- Materialet promovuese dhe reklamuese;
- Tabelat elektronike për informata;
- E-mailat dhe shkëmbimet e tjera elektronike;
- Makinat kërkuese;
- Lojërat;
- Dokumentet personale (si biografitë e njerëzve apo profilet personale);
- Oraret/ditarët.

6.2. ISBN-ja për produktet softuerike që i plotësojnë kriteret

Numri i ISBN-së mund të përdoret për ta identifikuar një produkt të caktuar softuerik që ka për qëllim të përdoret për çështje edukative-arsimore, si produktet kompjuterike për trajnime me kusht që nuk modifikohet e as nuk kërkon të dhëna me qëllim që të funksionojë.

Të gjitha produktet e tjera (p.sh. lojërat kompjuterike) nuk marrin ISBN.

6.3. Parimet për caktimin e ISBN-së për botimet elektronike dhe produktet softuerike që i plotësojnë kriteret

Botimet duhet të kenë numra të veçantë të ISBN-ve nëse kushdo në zinxhirin e furnizimit ka nevojë që t'i identifikojë ato në mënyrë të veçantë.

ISBN-ja është një identifikues për botimet monografike (libra) si dhe produktet e ngjashme që janë në dispozicion të publikut. ISBN-ja nuk duhet të përdoret për t'i identifikuar fajllat që vetëm kalojnë mes botuesve dhe radhitësve ose shërbimeve të konvertimit të librave elektronikë, e as nuk duhet t'i identifikojë entitetet abstrakte si veprat tekstuale (përmbajtjen).

Po ashtu është me rëndësi që të bëhet dallimi i rasteve të "produkteve" të ndryshme, që gjithmonë meritojnë numra të veçantë të ISBN-ve, si dhe rastin kur menaxhimi i të drejtave digjitale dhe shfrytëzimet e ndryshme të të drejtave janë pjesë përbërëse e produktit në momentin kur ndodh transaksioni mes shitësit dhe konsumatorit. Dallimi mund të mos jetë gjithnjë i dukshëm. Është me rëndësi që të kihet parasysh se nevojitet të kihen numra të veçantë të ISBN-ve për t'iu shmangur dykuptimësive që mund të dalin në zinxhirin e vlerave ku ka shumë produkte dhe shumë palë të përfshira.

Konsumatori duhet ta dijë: a) nëse libri elektronik që do ta blejë do të funksionojë në pajisjen ose softuerin e tij, dhe b) se çka mund të bëjë me të (p.sh. të kopjojë, të shtypë, japë në huazim, pajisja ia lexon tekstin me zë, etj.). Kjo përcaktohet zakonisht nga një kombinim i formatit të fajllit dhe softuerit që njihet si Menaxhimi i të Drejtave Digjitale (MDD), i cili e kontrollon, në aspektin teknik, shfrytëzimin që mund t'i bëhet librit elektronik. Numrat e ndryshëm të ISBN-ve do ta mundësojnë menaxhimin, shpërndarjen dhe gjetjen e informacionit, si dhe të dërgimit të versionit të përshtatshëm të një libri elektronik.

- Kur e kemi në formate të ndryshëm të fajllave një libër të caktuar elektronik që i plotëson kriteret, atëherë secili lloj i formatit që botohet dhe vihet veçmas në dispozicion duhet të ketë ISBN-në e vet.

N.B. *Një format i fajllit është një mënyrë e caktuar në të cilin është koduar informacioni për ruajtje në fajllin digjital. Në rastin e librave elektronikë, formatet e fajllave shpesh kombinohen me një lloj të caktuar të fajllit (si EPUB, .pdf, etj) dhe me softuerin e menaxhimit të të drejtave digjitale (si: Adobe ACS4, Apple Fairplay, etj.)*

- Kur përdoren softuerë me pronësi private për menaxhimin e të drejtave digjitale, të cilët e kufizojnë një version me një platformë, pajisje apo softuerë të caktuar, atëherë duhet të përdoren ISBN të veçanta për secilin prej versioneve të tilla.
- Kur botimet digjitale ofrohen nga një shitës me pakicë, i cili është edhe ofruesi i vetëm i librave elektronikë në atë format nën pronësi private e që mund të blihet vetëm përmes ueb-sajtit të tij (p.sh.: Amazon Kindle, Apple i-books), dhe se ai shitës me pakicë nuk kërkon ISBN, atëherë nuk është e nevojshme t’u caktohet ISBN këtyre versioneve, edhe pse mund të ishte e dobishme që t’u caktohej me qëllim të identifikimit të shitjeve ose për renditjen e botimeve në bazat e të dhënave të palëve të treta që kanë të bëjnë me librat elektronikë. Nëse caktohen numra të ISBN-ve, atëherë ata duhet të jenë unikë për atë version.
- Mund të caktohet numër i ri i ISBN-së kur një libër digjitalizohet nga një bibliotekë apo organizatë tjetër në rrethana të caktuara. Nëse versioni elektronik i ofrohet publikut, atëherë ai, si produkt i ri, duhet të identifikohet me ISBN të veçantë, pa marrë parasysh nëse aplikohet ndonjë pagesë, ose jo, për shfrytëzimin e versionit digjital.
- Kur një botim është në dispozicion në një zinxhir të furnizimit me më shumë se një lloj specifik të MDD-së, dhe nëse ofrohet nga botuesi origjinal apo ndonjë shitës më vonë në këtë zinxhir, atëherë secili prej këtyre produkteve unike duhet të identifikohet me ISBN unike.

Shembulli 1.: Botuesi i caktuar i prodhon dy versione EPUB të librit të njëjtë, secili me MDD të ndryshme dhe pastaj i shpërndan përmes zinxhirit të furnizimit, përmes ndërmjetësve të ndryshëm. Duhet të ketë ISBN të veçanta për secilin version specifik të MDD-së të atij produkti.

Shembulli 2.: Botuesi i caktuar e prodhon një fajll në formatin EPUB dhe ia jep këtë një shitësi, i cili i aplikon dy lloje të ndryshme të MDD-së formatit EPUB dhe i ofron të dy versionet veç e veç, si dy produkte që dallojnë prej njëri-tjetrit. Në këtë rast duhet që secili version specifik i DDM-së ta ketë ISBN-në e vet për atë produkt (ISBN-ja mund t'i caktohet nga botuesi ose nga shitësi nëse botuesi nuk e bën këtë më parë).

Shembulli 3.: Një shitës ia ofron publikut mundësinë që ta blejë një libër elektronik dhe ta modifikojë sipas kërkesës llojin e MDD-së që do të aplikohet. Në këtë rast, MDD-ja aplikohet në çastin e transaksionit dhe si rrjedhojë nuk ka nevojë të ketë ISBN të ndryshme meqë nuk shkaktohet ndonjë dykuptimësi apo pështjellim gjatë komunikimit mes shitësit dhe blerësit.

- Nëse një botim ofrohet në dispozicion me të drejta të ndryshme të shfrytëzimit (p.sh. përshtatja e kushteve të shfrytëzimit në atë mënyrë që shtypja të lejohet në njërin, por jo në tjetrin), atëherë secili version duhet ta ketë ISBN-në e vet unike. Gati në të gjitha rastet të drejtat e shfrytëzimit kontrollohen përmes kushteve të shfrytëzimit që përcaktohen në kuadër të softuerit të MDD-së.

Shembulli 4.: Botuesi i caktuar e nxjerrë një botim – njëri version i botimit është në dispozicion me veçori të tilla si leximi i tekstit nga pajisja (që kontrollohet përmes softuerit të MDD-së), dhe tjetri pa këtë veçori. Secili version duhet ta ketë ISBN-në e vet unike me qëllim që atributet e caktuara të jenë të qarta për blerësin dhe shfrytëzuesin potencial (posaçërisht ata që janë të interesuar për botime që ofrohen

përmes qasjes elektronike) dhe kështu ato versione të identifikohen veç e veç.

Megjithatë, edhe në këtë rast, kur të drejtat e shfrytëzimit identifikohen gjatë transaksionit midis shitësit dhe shfrytëzuesit, nuk kemi nevojë që t'u caktojmë ISBN të veçanta.

Shembulli 5: Botuesi i caktuar e nxjerr një botim në një format të caktuar me një ISBN, dhe pastaj ua ofron konsumatorëve një shërbim që paraqet të drejta të ndryshme të shfrytëzimit sipas nevojës së tyre. Ngjashëm me shembullin 3 më sipër, nuk ka nevojë për ISBN të veçanta për t'i identifikuar transaksionet individuale të përshtatura nga vetë blerësi apo shfrytëzuesi.

- Nëse botuesit përdorin ndërmjetësues për të gjeneruar formate të ndryshme të librave të tyre elektronikë, atëherë ata duhet të ofrojnë ISBN të veçanta për ndërmjetësuesit në mënyrë që ata t'ua caktojnë numrat secilit format.

(N.B. Metoda e përshkruar në këtë paragraf nuk rekomandohet si zgjidhje dhe duhet të përdoret vetëm në raste kur botuesi refuzon t'ua caktojë ISBN të veçanta secilit produkt të tij). Nëse një botues nuk i ofron numra të ISBN-së ndërmjetësueseve për secilin format të veçantë, atëherë ndërmjetësuesi mund t'ua caktojë numrat e vet të ISBN-së. Agjencitë e ISBN-së do t'ia ndajnë ndërmjetësuesit elementin e botuesit në kuadër të ISBN-së me qëllim që ta realizojë këtë synim. Në këtë rast ISBN-të dhe metadatat shoqëruese duhet t'i raportohen botuesit dhe agjencisë kombëtare të ISBN-së, si dhe agjencive të tjera bibliografike.

- Një varg aplikacionesh janë në fazën e zhvillimit e të cilat varen kryesisht prej formave të qarta të identifikimit. Edhe pse nuk janë plotësisht në punë ende, ato do të varen në identifikimin e qartë të produkteve të veçanta dhe në metadatat të detajuara me qëllim që të jenë të suksesshme.

Një shembull i kësaj është platforma që i dedikohet ofrimit të informacionit në lidhje me versionet me qasje elektronike. Me qëllim që të plotësohet kjo nevojë dhe dëshirë precize e shfrytëzuesit është me rëndësi që botimet e ndryshme me veçori të ndryshme të qasjes të identifikohen dhe të dallohen qartë prej njëra tjetrës. Me një identifikim të qartë të tillë të këtyre botimeve përmes numrave të veçantë të ISBN-së, shfrytëzuesi do të orientohet me saktësi te versioni më i përshtatshëm që ia plotëson nevojat e tij në çdo kohë. Po ashtu është e mundur që të parashikohen edhe lloje të tjera të aplikacioneve dhe të shërbimeve, të cilat do të vareshin kryesisht në një qasje të këtillë të detajuar.

- Një numër i vetëm i ISBN-së mund t'i mbulojë dy ose më shumë njësi në një pako që përbëhet prej produkteve softuerike dhe prej doracakëve të tij shoqërues teknikë dhe për përdorues, nëse doracakët janë të domosdoshëm për shfrytëzimin e softuerit dhe janë të dobishëm vetëm si plotësim i softuerit.

7. ISBN-ja PËR BOTIMET QË SHTYPEN SIPAS KËRKESËS

Për qëllim të caktimit të numrit të ISBN-së, shtypja sipas kërkesës është një formë e teknologjisë së shtypit.

Një botim i shtypur sipas kërkesës është ai botim që shtypet dhe lidhet për ta përbushur një porosi të caktuar nga një konsumator. Porositë e tilla kanë të bëjnë më së shpeshti me shtypjen e një ekzemplari të botimit, i cili përndryshe do të deklarohet si “jashtë botimit” meqë shtypja e tyre e rregullt nuk do të ishte më ekonomike.

Nëse versioni sipas kërkesës i një botimi është një formë tjetër e produktit prej versionit të mëparshëm të botuar në formë të

rregullt (p.sh. nëse një botim me kopertina të forta bëhet tash me kopertina të buta kur botohet sipas një kërkesë të caktuar), atëherë duhet t'i vihet ISBN e re, në të njëjtën mënyrë si për ndryshimet e tjera të formës së produktit. Ndryshimet e vogla, si zvogëlimi i madhësisë me qëllim që të përshtatet me makinat që e shtypin botimin sipas kërkesës, nuk kërkojnë caktimin e një ISBN-je të re.

Versioni "i modifikuar" ose "i personalizuar" i librave të shtypur sipas kërkesës, ku konsumatori e jo botuesi, e dikton përmbajtjen e librit, dhe i cili vihet në dispozicion të kufizuar, atëherë nuk duhet t'i vihet ndonjë ISBN.

8. VENDI DHE DUKJA E ISBN-së NË BOTIME

8.1. Informacion i përgjithshëm

ISBN-ja duhet të vendoset dhe duket në vetë botimin.

Në rastin e botimeve të shtypura, ISBN-ja duhet të vendoset:

- Në anën e pasme të faqes së titullit (faqja ku vendoset vërejtja për të drejtën autoriale);
- Në fund të faqes së titullit, nëse nuk ka hapësirë në anën e pasme të saj;
- Në seksionin e poshtëm, mbrapa kopertinës së jashtme;
- Në fund të anës së prapme të mbështjellësit të librit, apo të ndonjë mbështjellësi tjetër mbrojtës, apo mbështjellësi tjetër.

Në rastin e botimeve elektronike, ISBN-ja duhet të vendoset/duket:

- Në vendin ku shfaqet titulli; në ekranin/pamjen e parë (CD, botime onlajn); ose në ekranin që e shfaq titullin ose informacionin e barasvlershëm me të (p.sh. në ekranin fillestar që shfaqet kur i qasemi përmbajtjes për herë të parë dhe/ose në ekranin që e bart vërejtjen/informacionin e të drejtës autoriale).

Në rastin e filmave, videove, diapozitivave edukativo-arsimor, ISBN-ja duhet të vendoset/duket:

- Në vendin ku shfaqen kredencialet e përgjegjësve të materialit.

Nëse botimi del në mbajtës, i cili është pjesë integrale e botimit (p.sh. në CD, kasetë, ose disketë), ISBN-ja duhet të vendoset/duket në cilëndo etiketë që e shoqëron atë mbajtës. Nëse nuk është e mundur që të vendoset ISBN-ja në mbajtës ose në etiketën e tij, atëherë ISBN-ja duhet të vendoset në fund të pjesës së pasme të çfarëdo paketimi të përhershëm të atij mbajtësi (p.sh. kutia, mbështjellësi, ose korniza).

Formatet e ndryshme të një botimi elektronik duhet të kenë ISBN të veçanta nëse ofrohen në dispozicion veç e veç. Nëse një botim vihet në dispozicion në dy formate që gjithmonë lidhen/bëhen bashkë për t'u shitur, atëherë nevojitet vetëm një ISBN për të. Në rastin kur formatet vihen në dispozicion veç e veç, atëherë duhet të renditen të gjitha ISBN-të njëri pas tjetrit në të gjitha versionet, dhe se duhet të përmendet në kllapa formati në formë të shkurtuar në fund të numrit të ISBN-së.

Shembull:

ISBN 978-951-45-9693-3 (me kopertina të forta)

ISBN 978-951-45-9694-0 (me kopertina të buta)

ISBN 978-951-45-9695-7 (PDF)

ISBN 978-951-45-9696-4 (EPUB pa MDD)

ISBN 978-951-45-9999-5 (EPUB me MDD ACS4)

ISBN-ja duhet të vendoset po ashtu në materialin shoqërues i cili del së bashku me botimin.

ISBN-ja duhet të shtypet gjithnjë në madhësi të mjaftueshme që të duket qartë (d.m.th. 9 pikë ose më të madhe).

8.2. ISBN-ja në formën e barkodit

Përhapja e shpejtë në tërë botën e sistemit të skanimit të barkodit ka sjellë edhe marrëveshjen e arritur mes GS1 (i njohur më parë si EAN dhe Këshilli i Kodit Uniform – Uniform Code Council) dhe Agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-së dhe asaj të ISMN-së, që mundëson që ISBN-ja të kodohet në sistemin e barkodit EAN-13. Kjo e bën ISBN-në një identifikues ndërkombëtar, i cili është i përshtatshëm me skemat mbarëbotërore të barkodit.

Shfaqja e ISBN-së me simbolin e barkodit EAN-13 duhet të bëhet në pajtim me ISO/IEC 15420 (specifikimet e simbolikës së barkodit EAN/EUPC) që kërkon përdorimin e simboleve EAN-13 në pajtim me rekomandimet e GS1. Një barkod EAN përbëhet prej trembëdhjetë shifrave.

Më poshtë kemi dhënë një shembull të ISBN-së të koduar me simbolin e barkodit EAN-13:

ISBN 978-1-873671-00-9

Kur përdoret në barkod, ISBN-ja duhet të shfaqet në formë që mund të lexohet nga syri i njeriut dhe të vendoset menjëherë mbi simbolin e barkodit EAN-13, i paraprirë nga akronimi “ISBN”.

Shembull i shtypjes së ISBN-së sipas simbolit të barkodit EAN-13:

ISBN 978-1-873671-00-9



Grupi i agjencive të ISBN-së dhe Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së ofron informata më të shumta sa i përket aplikimit dhe përdorimit të simbolit të barkodit EAN-13. Grupi i agjencive inkurajohet që të bashkëpunojë drejtpërdrejtë me organizatat e GS1 në shkallë kombëtare ose rajonale.

Vendi i rekomanduar për vendosjen e simbolit të barkodit EAN-13 në botime është këndi i poshtëm në të djathtë në pjesën e prapme të kopertinës, afër shpinës së librit.

8.3. Numri i shtuar pesëshifrorë në kod

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kanada, barkodit i shtohet edhe një numër pesëshifrorë në tregun e librit për ta treguar çmimin. Për më shumë informacione sa i përket barkodeve në Shtetet e Bashkuara dhe në Kanada, ju lutem vizitoni ueb-sajtin e Grupit Studimor të Industrisë së Librit (ang: Book Industry Study Group): www.bisg.org.

Numri pesëshifrorë që i shtohet barkodit nuk duhet të përdoret në vende të tjera për informata të çmimit, edhe pse mund të përdoret me një prefiks "9" për shfrytëzim të brendshëm të botuesit (p.sh., për menaxhimin e botimeve të kthyera). Këto kode plotësuese gjithmonë fillojnë me "9" në kuadër të një serie shifrore "90000-98999".

8.4. Algoritmi për gjenerimin e ISBN-së dhe barkodit EAN.UCC

Shih *shifrën e kontrollit* (seksioni A1.1., shtojca) për informata lidhur me llogaritjen e shifrës së kontrollit të ISBN-së. Shih *përndarjen e serisë së numrave* (A1.2., shtojca) për informata formuluese që nevojiten për ta bërë ndarjen e ISBN-së.

9. ADMINISTRIMI I SISTEMIT TË ISBN-SË

9.1. Informacione të përgjithshme

Administrimi i sistemit të ISBN-së bëhet në tri nivele: prej agjencisë ndërkombëtare, agjencisë kombëtare/rajonale/gjuhësore të ISBN-së, dhe prej botuesit.

9.2. Administrimi ndërkombëtar

Funksionet dhe përgjegjësitë kryesore të Agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-së janë:

- Të promovojë, të bashkërendojë dhe të mbikëqyrë përdorimin mbarëbotëror të sistemit të ISBN-së;
- T'i përfaqësojë interesat e bashkësisë së ISBN-së para organizatave të tjera përkatëse;
- T'i caktojë organizatat përkatëse si agjenci kombëtare/rajonale/gjuhësore të ISBN-së dhe të heqjes së një të drejte të tillë në rast nevojë;
- T'i përcaktojë grupet dhe fushën e përgjegjësisë së tyre, dhe ndarjen e tyre nëpër agjencitë përkatëse të ISBN-ve;
- Ta bëjë përkufizimin e rregullave të grupeve që e menaxhojnë gjatësinë e elementeve në dispozicion për botuesit në kuadër të secilit grup dhe të sigurojë që regjistri i plotë dhe i saktë i këtyre rregullave të jetë në dispozicionin e publikut gjatë gjithë kohës;
- Ta caktojë serinë e numrave unikë të botuesve në kuadër të grupit të caktuar të agjencisë kombëtare/rajonale/gjuhësore të ISBN-së dhe ta mirëmbajë regjistrin e plotë dhe të saktë të elementeve të ndarë të botuesve;

- Ta sigurojë mirëmbajtjen e numrave të ISBN-së dhe të metadatave që e shoqërojnë ISBN-në përmes regjistrave të agjencive kombëtare/rajonale/gjuhësore të ISBN-së;
- Të hartojë, të monitorojë dhe të fusë në fuqi rregulla dhe procedura të cilat e qeverisin veprimtarinë e agjencive të ISBN-së dhe të procesit të regjistrimit të ISBN-ve prej atyre agjencive, duke përfshirë edhe pagesat që kanë të bëjnë me atë proces;
- Të ndihmojë në analizimin dhe ofrimin e zgjidhjeve për dhënien e numrave dublikatë të ISBN-së;
- Të analizojë dhe të vendosë sa i përket ndonjë ankese lidhur me vendimet e marra nga agjencitë kombëtare/rajonale/gjuhësore;
- Të hartojë, të mirëmbajë, dhe të vejë në dispozicion të publikut dokumentacionin për shfrytëzuesit e sistemit të ISBN-së;
- Ta zbatojë dhe të mirëmbajë sistemin e financimit, sipas nevojës, për ta mbështetur veprimtarinë e Agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-së, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në to, kontributet financiare nga agjencitë kombëtare/rajonale/gjuhësore të ISBN-ve.

9.3. Agjencitë kombëtare/rajonale/gjuhësore të ISBN-së

Administrimi i sistemit të ISBN-së në kuadër të grupit është përgjegjësi e agjencisë kombëtare të ISBN-së. Agjencia e ISBN-së mund të veprojë në shkallë kombëtare, rajonale, gjuhësore, ose ndarje të tjera të arsyeshme të përgjegjësisë, sipas bazës së ndarjes grupore.

Në kuadër të grupit mund të ketë disa agjenci kombëtare (p.sh. identifikuesi grupor 978-0 dhe 978-1 kanë agjenci të veçanta në Australi, në pjesën anglishtfolëse të Kanadasë, Mbretëri të Bashkuar, Shtete të Bashkuara, e kështu më radhë).

Funksionet dhe përgjegjësitë e agjencive kombëtare/rajonale/gjuhësore të ISBN-ve janë:

- Të sigurojnë ofrimin e vazhdueshëm të shërbimit;
- T'i dërgojnë njoftime botuesit për caktimin e një ISBN-je ose të një elementi të botuesit për atë botim monografik ose emër të botuesit;
- Të krijojnë, të menaxhojnë, dhe të mirëmbajnë regjistrat e ISBN-së, metadatat e ISBN-së dhe të dhënat administrative në pajtim me rregullat e përcaktuara nga Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së. (Përgjegjësitë lidhur me metadatat e ISBN-së mund t'i delegohen agjencisë përkatëse bibliografike me kusht që t'u përmbahet këtyre specifikacioneve);
- Të përmirësojnë numra dhe metadatat e pasakta të ISBN-së nëse ka dëshmi se ka ndodhur një pasaktësi;
- T'i vejnë në dispozicion numrat e ISBN-së dhe metadatat shoqëruese për agjenci të tjera dhe për shfrytëzuesit e sistemit të ISBN-së në pajtim me rregullat e përcaktuara nga Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së;
- Të sistemojnë dhe të mirëmbajnë të dhëna statistikore sa i përket veprimtarisë së tyre që kanë të bëjnë me ISBN-në, si dhe t'i raportojnë këto të dhëna Agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-së në intervale të përcaktuara kohore;

- Të promovojnë, të edukojnë dhe të trajnojnë të tjerët lidhur me shfrytëzimin e sistemit të ISBN-së në pajtim me specifikat e përcaktuara të botimit në fuqi të standardit të ISBN-së;
- Të respektojnë rregullat dhe procedurat e ISBN-së të përcaktuara nga Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së në pajtim me specifikacionet e përcaktuar në botimin në fuqi të standardit të ISBN-së.

9.4. Administrimi nga botuesi

Botuesit janë përgjegjës për caktimin e elementit të botimit për secilin titull që e botojnë dhe sigurohen për aplikimin e rregullave të përcaktuara. Ata mund të aplikojnë dhe ta marrin elementin e botuesit nga Agjencia kombëtare/rajonale/gjuhësore e ISBN-së së bashku me fajllin e shtypur ose elektronik të ISBN-ve që janë në dispozicion për ta në kuadër të elementit të botuesit të ndarë për ta. Disa agjenci të ISBN-së mund të kërkojnë pagesë për këto shërbime.

Agjencia e ISBN-së do ta përcaktojë serinë e elementeve të botimit që do të jenë në dispozicion për botuesin. Kjo seri elementesh do të përcaktohet në bazë të botimeve aktuale dhe parashikimeve për të ardhmen, si dhe lidhet drejtpërdrejt me gjatësinë e elementit e caktuar të botuesit. Botuesi duhet të sigurohet që agjencia e ISBN-së ka informacione të bollshme lidhur me listën e botimeve të dala më parë, dhe duhet ta këshillojë agjencinë për të gjitha botimet aktuale dhe të ardhshme me qëllim që të caktohet një element i mjaftueshëm i botuesit.

Botuesi duhet t'i ofrojë agjencisë së ISBN-së (ose agjencisë së caktuar vendore bibliografike) informata specifike të metadatave lidhur me botimin të cilit ia ka caktuar numrin e ISBN-së. Specifikacionet lidhur me llojin dhe formatin e metadatave hartohen nga Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së në bashkëpunim

me agjencitë kombëtare/rajonale/gjuhësore të ISBN-së (shih seksionin 5.13 më lartë).

Informacione të tjera lidhur me udhëzimet sa i përket sistemit të ISBN-së mund të merren në agjencinë përkatëse të ISBN-së.

10. BOTUESIT MOSPJESËMARRËS

Në rast të mospjesëmarrjes së ndonjë botuesi në skemën e ISBN-së, agjencia përkatëse duhet ta kontaktojë atë dhe ta këshillojë lidhur me rëndësinë dhe vlerën e vendosjes së numrave të ISBN-ve në të gjitha botimet e tij, të cilat i plotësojnë kriteret, si dhe t'i ofrojë informacione të plota lidhur me përvetësimin e standardit.

Në rastin e botuesve që e botojnë aty këtu ndonjë titull dhe të cilët nuk duket se do të jenë ndonjëherë në pozitë që t'i marrin vetë përgjegjësit për numërim, atëherë agjencia kombëtare/rajonale/gjuhësore mund ta caktojë një element të botuesit, të cilin ua dedikon botuesve të ndryshëm që nuk marrin pjesë, dhe t'ua numërojnë të gjitha botimet duke e përdor atë bllok elementesh, pa marrë parasysh botuesit në fjalë. Kjo praktikë mund të përdoret duke ushtruar një kontroll të rreptë për shkak të pështjellimit që mund të sjellë, duke qenë një përjashtim i rregullës së përgjithshme të një elementi të botuesit për një botues. Në këto raste, vetëm ISBN-të përkatëse nga kjo ndarje, dhe jo elementi i botuesit, mund ta identifikojë një botues të caktuar.

Në disa vende agjencia kombëtare/rajonale/gjuhësore ua cakton numrat e ISBN-së botimeve, të cilat i merr si pjesë e kopjes së detyrueshme dhe që nuk kanë të caktuar ndonjë numër të ISBN-së më parë. Grupi i agjencisë pastaj e informon botuesin lidhur me ISBN-në që ia ka vënë botimit të tij dhe e boton atë në bibliografinë kombëtare të vet.

11. ISBN-ja DHE GS1

Në vitin 1977 u përmyll një marrëveshje mes EAN ndërkombëtar (EAN), Këshillit të Kodit Uniform (UCC), Agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-së, dhe Agjencisë Ndërkombëtare të ISMN-së për të bashkëpunuar në mënyrë reciproke. Ajo ofron statusin e vëzhguesit për përfaqësuesit përkatës në kuvendet e përgjithshme të njëri-tjetrit, ofron këshilla, si dhe e rregullon numërimin e materialeve libra që nuk shtypen. Në shkurt të vitit 2005, EAN dhe Këshilli i Kodit Uniform (UCC) u bashkuan nën emrin GS1.

Informacionet kontaktuese:

GS1 Global Office

Blue Tower

Avenue Louise 326

B-1050 Brussels

Belgium

Tel: (+32 2) 788 7800

Fax: (+32 2) 788 7899

Email: contactus@gs1.org

URL: <http://www.gs1.org>

Informacionet kontaktuese për organizatat GS1:

<http://www.gs1.org/contact>

12. ISBN-ja DHE IDENTIFIKUESIT E TJERË

12.1. DOI

Sistemi i Identifikuesit të Objekteve Digjitale (DOI® – Digital Object Identifier) përdoret për identifikimin e objekteve përmbajtjesore në mjedisin digjital. Emrat DOI® u caktohen secilit entitet për shfrytëzim në rrjetin digjital. Ata përdoren për të ofruar informacione aktuale, duke përfshirë se ku mund të gjinden në

internet (apo informacione për ta). Informacionet për një objekt digjital mund të ndryshojnë me kalimin e kohës, duke përfshirë edhe lokacionin se ku mund të gjendet, porse emri i DOI nuk do të ndryshojë.

Fondacioni ndërkombëtar i DOI-it

Tel: +44 (0)1865 559070.

Email: n.paskin@doi.org

URL: <http://www.doi.org>

12.2. ISBN-A

ISBN-ja në veprim (ISBN-A – Actionable ISBN) është sintaksë dhe shërbim i ofruar nga disa agjenci të ISBN-ve që mundësohen nga DOI®, ku një ISBN ekzistuese shprehet në sistemin e DOI, duke mundësuar që një ISBN të lidhet me një ose më shumë URL.

International ISBN Agency

United House

North Road

London N7 9DP

United Kingdom

Tel: +44 (0)20 7503 6418

Email: info@isbn-international.org

URL: <http://www.doi.org/factsheets/ISBN-A.html>

12.3. GTIN

GTIN (Numri i Artikullit për Tregti Globale – Global Trade Item Number) është një term i përgjithshëm për të gjithë identifikuesit e produkteve EAN.UCC, duke përfshirë edhe paraqitjen EAN-13 të ISBN-së.

GS1 Global Office
Blue Tower
Avenue Louise 326
B-1050 Brussels
Belgium
Tel: (+32 2) 788 7800
Fax: (+32 2) 788 7899
Email: contactus@gs1.org
URL: <http://www.gs1.org/barcodes/technical/idkeys/gtin>

12.4. URN

URN-të (URN – Uniform Resource Names) janë identifikues të përshtur të burimeve. Sintaksa e tyre e përcaktuar në standardin e internetit RFC 2141, është:

`<URN>:= "urn:" <NID> ":" <NSS>`

ku <NID> është identifikues i hapësirës së emrit dhe <NSS> është vargu specifik i hapësirës së emrit. Identifikuesi në fillim "urn:" dhe identifikuesi i hapësirës së emrit karakterizohen me respektimin e mënyrës së paraqitjes së karaktereve.

NID "isbn" është rezervuar për sistemin e ISBN-së në RFC 3187 (shih vjegëzën më poshtë). Sipas kësaj RFC, secila URN e bazuar në ISBN i përmbahet sintaksës në vijim:

`urn:isbn:<NSS>`

ku vargu specifik i hapësirës së emrit e përmban ISBN-në në formatin që mund të lexohet nga makina. Për shembull:

`urn:isbn:9780110002224`

<http://tools.ietf.org/html/draft-ietf-urnbis-rfc3187bis-isbn-urn-00>

12.5. ISAN

Numri Standard Ndërkombëtar Audio-vizual (ISAN) është një sistem vullnetar i numërimit dhe skemë metadatash që mundëson identifikimin e çfarëdo vepre audio-vizuale, duke përfshirë filmat, dokumentarët, programet televizive, ngjarjet sportive, reklamat, si dhe versionet e tyre të ngjashme.

ISAN është e regjistruar si ISO15706-1 dhe 15706-2.

Autoriteti regjistruar për ISAN është:

ISAN International Agency

1A, rue du Beulet

CH-1203 Geneva

Switzerland

Phone: (+41) 22 545 10 00

Fax: (+41) 22 545 10 40

Email: info@isan.org

URL: <http://www.isan.org>

12.6. ISMN

Numri Standard Ndërkombëtar i Muzikës (ISMN) i identifikon të gjitha botimet muzikore të shtypura në fletë, pa marrë parasysh nëse janë për t'u shitur, janë marrë me qira ose jepen falas.

ISMN-ja mund të integrohet në barkodin ndërkombëtar 13 shifrorë, duke e përdorur prefiksin 979-0. Shkronjës "M" i caktohet vlera numerike zero (0) vetëm për qëllim të barkodit.

ISMN-ja nuk përdoret për libra që kanë të bëjnë me muzikën, ato marrin ISBN, e as nuk përdoret për kaseta muzikore, CD, ose video.

ISMN-ja administrohet nga Agjencia e ISMN-së:

International ISMN Agency
Schlossstr. 50 12165
Berlin, Germany
Tel.: (+49 30) 7974 5002
Fax: (+49 30) 7974 5254
Email: ismn@ismn-international.org
URL: <http://ismn-international.org>

12.7. ISRC

Kodi Standard Ndërkombëtar për Incizime (ISRC) është standard identifikues ndërkombëtar për incizime zanore dhe video muzikore (ISO 3901). E numëron secilin incizim të një pjese (jo ekzemplarin fizik), pa marrë parasysh kontekstin ose mbajtësin në të cilin është botuar. Kodimi në ISRC mundëson identifikimin automatik të incizimeve për qëllim të pagesave të taniemave.

Sistemi i ISRC-së administrohet nga IFPI, Federata Ndërkombëtare e Industrisë Fonografike:

International ISRC Agency
IFPI Secretariat
10 Piccadilly
London
W1J 0DD
United Kingdom
Tel: +44 (0)20 7878 7900
Fax: +44 (0)20 7878 7950
Email: isrc@ifpi.org
URL: <http://www.ifpi.org/isrc>

12.8. ISSN

Numri Standard Ndërkombëtar i Botimeve Serike (ISSN), ISO 3297, është identifikues standard ndërkombëtar për botimet serike (d.m.th. botime që dalin herë pas here pa ndonjë fund të paracaktuar). Botimet e tilla zakonisht dalin në numra të njëpasnjëshëm ose të integruar që në përgjithësi kanë përcaktues numerik dhe/ose kronologjik. Shembuj tipikë janë botimet serike të gazetave, periodikëve, revistave, magazinave, etj., dhe burimet e vazhdueshme të integruara si botimet me fletë të palidhura të cilat përditësohen vazhdimisht.

ISSN-ja administrohet nga Qendra Ndërkombëtare e ISSN-së:

ISSN International Centre

5 rue de Turbigo

75003 PARIS

FRANCE

Tel: (+33) 1 44 88 22 20

Fax: (+33) 1 40 26 32 43

Email: issnic@issn.org

URL: <http://www.issn.org>

Disa botime, si vjetarët, botimet serike të monografive, etj., duhet të marrin numër të ISSN-së për titullin serik (i cili mbetet i njëjtë për të gjitha pjesët ose vëllimet individuale të botimit serik), dhe ISBN për secilin vëllim individual. Nëse numri i ISBN-së dhe i ISSN-së i caktohet një botimi, atëherë të dytë duhet të identifikohen qartë në atë botim.

12.9. ISTC

Kodi Standard Ndërkombëtar i Teksteve (ISTC), ISO 21047, është një sistem numërimi për identifikimin unik të veprave tekstuale; termi 'vepër' mund t'i referohet çdo përmbajtje që shfaqet në librat e shtypur konvencionalë, audio-libra, libra

elektronikë, libra statikë apo libra digjitalë të pasuruar, si dhe përmbajtja që shfaqet në gazeta apo revista.

ISTC-ja nuk i caktohet produktit fizik ose llojeve të tjera të manifestimit të një vepre. Produktet e tilla fizike (d.m.th. libri i shtypur, audio-libri, apo versione elektronike të produkteve të këtilla) marrin ISBN.

Mund të gjeni më shumë informata nga:

EDItEUR

United House North Road

London N7 9DP

UK

Tel: +44 (0)20 7503 6418

Fax: +44 (0)20 7503 6418

Email: info@editeur.org

URL: www.istc-international.org

12.10. ISWC

Kodi Standard Ndërkombëtar për Vepra Muzikore (ISWC) i identifikon veprat muzikore si krijim i paprekshëm. Nuk përdoret për identifikimin e manifestimeve të, ose objekteve në lidhje me, veprat muzikore. Manifestimet dhe objektet e tilla i nënshtrohen një sistemi të veçantë të identifikimit, si ISRC dhe ISMN (shih shpjegimet gjetkë në këtë seksion).

Shembull: *Die Zauberflöte* (Flauta magjike) e Moxartit kualifikohet për ISWC për ta identifikuar veprën. Partiturat e shumta të shtypura do të kualifikoheshin secila për ISMN, libreti dhe përkthimet e saj do të merrnin ISTC (dhe ISBN për botimet në fjalë); një video në lidhje me interpretimin do të merrte ISAN, si dhe incizimi zanor i operës do të merrte ISRC.

Më shumë informacione mund të gjenden nga autoriteti i regjistrimit:

CISAC
20-26 Boulevard du Parc
92200 Neuilly sur Seine
France
Tel.: (+ 33 1) 55 62 08 50
Fax: (+ 33 1) 55 62 08 60
Email: cisac@cisac.org
URL: <http://www.cisac.org>

12. 11. ISNI

Identifikuesi Standard Ndërkombëtar i Emrave (ISNI) është një standard ISO në përpunim e sipër (ISO 27729), fushëveprimi i së cilit është që të bëjë identifikimin e identiteteve publike të palëve: kjo do të thotë, identitetet që përdoren publikisht nga palët e përfshira në industrinë mediatike të përmbajtjes, si në zinxhirin e krijimit, prodhimit, menaxhimit, dhe shpërndarjes. Sistemi i ISNI-s i identifikon në mënyrë unike identitetet publike në fusha të ndryshme të veprimtarisë së tyre krijuese. ISNI-ja paraqet një instrument për identifikimin e saktë të identiteteve publike që përndryshe mund të përziheshin. ISNI nuk ka për qëllim që të ofrojë qasje të drejtpërdrejtë në informata të gjera për një identitet të caktuar publik, por mundëson lidhje me sistemet e tjera ku mbahet apo ruhet ai informacion.

Mund të gjeni më shumë informata nga:

ISNI International Agency Ltd
c/o ALCS
The Writers' House
13 Haydon Street
London EC3N 1DB
UK
Email: info@isni.org
URL: <http://www.isni.org>

13. ONIX PËR LIBRA

ONIX për Mesazhet Informative të Produkteve Libra është standard ndërkombëtar për paraqitje dhe komunikim të informacioneve të produkteve në industrinë e librit në formë elektronike.

ONIX për libra është zhvilluar nga EDItEUR së bashku me Grupin e Studimit të Industrisë së Librit (SHBA), Komunikimit në Industrinë e Librit (Mbretëri e Bashkuar), dhe tani përdoret gjithandej globit. Zhvillimi i vazhdueshëm i ONIX tani menaxhohet nga një rrjet i Grupeve Kombëtare dhe një Komiteti Drejtues Ndërkombëtar, i cili bashkërendohet nga EDItEUR. Versioni më i fundit, në kohën kur është shkruar ky doracak, është versioni 3.0.

Përvoja ka treguar për botuesit se ONIX për Libra i sjell dy gjëra të dobishme në biznes. Si format komunikimi e bën të mundur dërgimin e informatave të rëndësishme të produktit në zinxhirin furnizues në një formë standarde si te shitësit me shumicë ashtu edhe te shpërndarësit, pastaj te shitësit me pakicë, mbledhësit e të dhënave, e gjithashtu edhe te kompanitë përkatëse. Duke ofruar një shabllon për përmbajtjen dhe strukturën e njësisë së produktit, ONIX ka ndihmuar që ta nxisë futjen e sistemeve më të mira të brendshme të informacionit, të cilat janë në gjendje t'i sjellin në një vend të gjitha "metadatat" e nevojshme për përshkrimin dhe promovimin e titujve të rinj dhe listave të mëparshme. Të njëjtat të dhëna mund të përdoren për të prodhuar informacione më të avancuara, katalogë, si dhe materiale të tjera promovuese.

Për partnerët e zinxhirit furnizues të atypëratyshëm në internet, ONIX për libra nënkupton ngarkim më efikas dhe më të shpejtë të informacioneve të përditësuara në sistemet e konsumatorëve, me më pak nevojë të intervenimit manual dhe me më pak rrezik për gabime.

ONIX për libra është në harmoni me MARC21 nga Biblioteka e Kongresit dhe me UNIMARC nga Biblioteka e Britanisë. Përdoret nga disa biblioteka kombëtare për të marrë informacione të produktit nga botuesit për katalogun në botim (CIP) ose për t'i pasuruar katalogët e tyre elektronikë në internet.

Tani më janë në dispozicion specifikacionet për një lloj të ONIX për libra, që ka për qëllim specifik bartjen e metadatave të nevojshme për regjistrimin e ISBN-së. Kjo mund të përdoret nga botuesit për t'i informuar agjencitë kombëtare/rajonale/gjuhësore lidhur me numrat e ISBN-së që i kanë caktuar për produktet e tyre, me rastin kur nuk është i nevojshëm një mesazh i plotë i ONIX për libra.

Mund të gjeni më shumë informacione:

EDItEUR
United House North Road
London N7 9DP
UK
Tel: +44 (0)20 7503 6418
Fax: +44 (0)20 7503 6418
Email: info@editeur.org
URL: <http://www.editeur.org/8/ONIX/>

14. BOTIMET

Direktoriumi i Botuesve Ndërkombëtarë i ISBN-së (PIID)

Direktoriumi i botuesve ndërkombëtar i ISBN-së i përfshin të gjithë elementet e botuesve dhe informacionet kontaktuese të tyre. Aktualisht botohet në dy forma, edhe në versionin e shtypur edhe atë elektronik.

Për më shumë informata, ju lutem vizitoni URL: <http://isbn-international.org/page/directory>

15. PYETJET E SHPESHTA LIDHUR ME SISTEMIN E ISBN-së

Shih seksionin e pyetjeve të shpeshta të ISBN-së në:
<http://isbn-international.org/faqs>

Shtojca 1.: Llogaritja e shifrës së kontrollit dhe përndarja e serisë së numrave të ISBN-së

A1.1. Llogaritja e shifrës së kontrollit

Secila prej 12 shifrave të para të ISBN-së është e shumëzueshme më 1 dhe 3. Shifra e kontrollit është e barabartë me 10 minus mbetja që vjen prej pjesëtimit me 10 të shumës së rezultatit të vlerës dhe 12 shifrave të para të ISBN-së, me vetëm një përjashtim. Nëse kjo llogaritje rezulton në shifër kontrolli 10, atëherë shifra e kontrollit është 0.

Përdorni hapat në vijim për ta llogaritur shifrën e kontrollit për numrin e ISBN-së 978-0-11-000222-?

Hapi 1.: Përcaktojeni shumën e rezultatit të vlerës dhe 12 shifrave të para të ISBN-së (shih tabelën më poshtë).

	Elementi i prefiksit			Elementi i grupit	Elementi i botuesit		Elementi i botimit						Shifra e kontrollit	Shuma
	9	7	8	0	1	1	0	0	0	2	2	2		
ISBN	9	7	8	0	1	1	0	0	0	2	2	2	?	
Vlera	1	3	1	3	1	3	1	3	1	3	1	3	-	
Rezultati	9	21	8	0	1	3	0	0	0	6	2	6	-	56

Hapi 2.: Pjesëtoni me 10 shumën e rezultatit të vlerës dhe 12 shifrave të para të ISBN-së që e keni llogaritur në hapin 1, gjeni mbetjen.

$$56/10 = 5 \text{ mbetja} = 6$$

Hapi 3.: Zbritni me 10 mbetjen e llogaritur në hapin 2. Dallimi i dalë është vlera e shifrës së kontrollit, përveç në një rast. Nëse mbetja në hapin 2 është 0, shifra e kontrollit është 0.

$$10 - 6 = 4$$

$$\text{Shifra e kontrollit} = 4$$

ISBN-ja = 978-0-11-000222-4

Formula e mëposhtme matematikore është mënyrë alternative e përlllogaritjes së shifrës së kontrollit:

Shifra e kontrollit = mod 10 (10 – [mod 10 {shuma e rezultatit të 12 shifrave të para të ISBN}}])

Shifra e kontrollit = mod 10 (10 –[mod 10{56}}])

Shifra e kontrollit = 4

Shuma e rezultatit të 12 shifrave të para plus shifra e kontrollit duhet të jenë të pjesëtueshme me 10 pa mbetje që një ISBN të jetë e vlefshme.

Vërejtje: Gjatësia e elementit të grupit, e elementit të botuesit dhe elementit të botimit ndryshojnë dhe nuk janë gjithnjë të njëjta si në shembullin e dhënë në tabelën më sipër. Jo të gjitha kombinimet e grupit dhe të elementit të botimit janë të vlefshme. Shih seksionin *Përndarja e serisë së numrave të ISBN-së* për informatat e nevojshme për vlefshmërinë dhe ndarjen e një ISBN-je.

Ju lutem kontaktoni agjencinë tuaj vendore të ISBN-së, e cila është në gjendje t'ju ndihmojë në llogaritjen e numrave të ISBN-së, ose duke ju ofruar lista të përlllogaritura më parë të numrave të ISBN-së, ose duke ju dhënë softuerin që ju mundëson që vetë t'i llogaritni numrat e ISBN-së.

A1.2. Përndarja e serisë së numrave të ISBN-së

Seria e numrave ndahet sipas kërkesës së parashikuar (d.m.th. sa i madh është një program botimi) në kuadër të një rajoni të caktuar ose grupi gjuhësor. Disa elemente të grupit janë të rezervuar nga Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së me qëllim që të sigurohen kapacitetet në të ardhmen. Agjencia Ndërkombëtare e

ISBN-së do t'i caktojë këta numra sipas nevojës në rastin kur ngushtohen mundësitë në një grup të caktuar. Përveç kësaj, edhe seria e numrave të elementit të botuesve në kuadër të një grupi që veçse është i caktuar në një grup rajonal ose gjuhësor mund të mbetet i padefinuar në mënyrë që të shërbejë për përmbushjen e nevojave në të ardhmen.

Detaje gjithëpërfshirëse lidhur me grupet dhe serinë e numrave të botuesve mund të merren nga Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së, që mundëson vlefshmërinë e numrave aktualë të serive të caktuara. Nuk janë gjithmonë të vlefshme të gjitha kombinimet e grupit dhe të botuesit. Informatat formuluese (duke i shfrytëzuar metadatat gjithëpërfshirëse të serisë së grupit dhe të botuesit) që nevojiten për ta ndarë ISBN-në në pjesët e saj përbërëse janë dhënë më poshtë: Shih seksionin *Llogaritja e shifrës së kontrollit* për informata lidhur me llogaritjen e shifrës së kontrollit dhe vlefshmërinë e saj.

Numri i shifrave në secilin element të ISBN-së për grupin, botuesin, dhe botimin ndryshojnë në gjatësi, edhe pse numri i shifrave që gjenden në kuadër të këtyre tri elementeve është gjithsej 9. Këto nëntë shifra, së bashku me elementin treshifrorë të prefiksit dhe shifrën e kontrollit, e përbëjnë ISBN-në 13 -shifrore. Numri i shifrave në elementin e grupit dhe të botimit do të ndryshojë sipas botimeve që dalin prej atij grupi ose prej botuesit në fjalë. Grupeve për të cilat parashihet botim më i madh i materialeve monografike u caktohen grup-numrash prej një ose dy shifrash. Botuesit që priten të nxjerrin botime të shumta u caktohen numra të botuesve prej dy ose tre shifrash.

Vërejtje: Numri i shifrave të specifikuar dhe të caktuar për grupet dhe botuesit në kuadër të elementit të prefiksit 978 nuk mund të mbështetet në parashikimet, të cilat janë specifikuar dhe caktuar në kuadër të elementeve të ardhshme të prefiksit (p.sh. elementi i prefiksit 979). Caktimi i numrave për grupet dhe botuesit

për prefikset e ardhshëm do ta reflektojnë historinë e ndarjeve dhe projektimet e ndarjeve në të ardhmen për të gjithë sistemin e elementeve të prefiksit në aspektin e përgjithshëm.

Qëllimi është që prefikset grupore prej 979 do të caktohen vetëm në nivel të agjencisë kombëtare. Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së do të përpiqet t'i shmanget caktimit të prefikseve gruporë që do të ndaheshin mes shumë agjencish në bazë të gjuhës së përbashkët. Prefikset gruporë prej 979 do të caktohen sipas nevojës kur shterohen ndarjet aktuale, por deri më tani nuk ka ndonjë tabelë të përndarjes 979 të ngjashme si "Tabela 1" më poshtë.

Përcaktimi i ndarjeve të brendshme të ISBN-së 13-shifrore është një proces me dy hapa: së pari, përcaktojeni grupin, duke i shfrytëzuar rregullat për elementet e prefiksit të caktuar për ISBN; së dyti: përcaktojeni gjatësinë e elementit të botuesit dhe të botimit duke i shfrytëzuar rregullat e grupit. Rregullat e grupit ofrohen prej Agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-së.

Tabela 1. ilustron përndarjen e serisë së numrave për grupin në kuadër të elementit të prefiksit 978. Cilido prefiks tjetër i EAN.UCC i vënë për shfrytëzim në kuadër të sistemit të ISBN-së do të ketë rregulla brenda grupit që përcaktohen nga Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së para se të caktohet grupi në kuadër të atij prefiksi të EAN.UCC. *Ju rekomandojmë që të këshilloheni vazhdimisht me Agjencinë Ndërkombëtare të ISBN-së për plotësime ose ndryshime të mundshme të rregullave të grupit.*

Tabela 1.: Përndarja e serisë së numrave për grupin në kuadër të elementit të prefiksit 978

Elementi i prefiksit	Seria e elementit të grupit	Numrat në dispozicion të grupit
978	0 – 5	100,000,000
	600-649	1,000,000
	6500000-6999999	(seri numrash e papërcaktuar)
	7	100,000,000
	80 – 94	10,000,000
	950 – 989	1,000,000
	9900 – 9989	100,000
	99900 – 99999	10,000

Tabela 2. ilustron se si të përfitohet struktura e grupit brenda elementit të prefiksit 978 për një ISBN të caktuar. Një ekzaminim i pesë shifrave pas elementit të prefiksit lejon përcaktimin e gjatësisë së elementit të grupit. Pasi që të dihet gjatësia e grupit, pastaj mund të nxirret edhe grupi i botuesit.

Tabela 2.: Metoda e përfitimit të strukturës së grupit për elementin e prefiksit 978

Nëse pesë shifrat pas elementit të prefiksit janë midis:	Gjatësia e grupit është:	Ndarjet e elementit të prefiksit dhe e grupit do të ndodhnin pas secilës prej shifrave në vijim dhe elementeve shoqëruese:
00000 – 59999	1	3-të (elementi i prefiksit) 4-të (grupi)
60000 – 64999	3	3-të (elementi i prefiksit) 6-të (grupi)
65000 – 69999	0 (i papërcaktuar)	(seri e papërcaktuar)
70000 – 79999	1	3-të (elementi i prefiksit) 4-të (grupi)
80000 – 94999	2	3-të (elementi i prefiksit) 5-të (grupi)
95000 – 98999	3	3-të (elementi i prefiksit) 6-të (grupi)
99000 – 99899	4	3-të (elementi i prefiksit) 7-të (grupi)
99900 – 99999	5	3-të (elementi i prefiksit) 8-të (grupi)

Gjatësia e elementit të botuesit krijohet brenda secilit grup nga agjencitë kombëtare/rajonale/gjuhësore e ISBN-së në pajtim me nevojat e industrisë së botimit brenda një hapësire të caktuar. Seria e numrave që i caktohen secilit grup duhet të krijohen paraprakisht nga Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së, para se të përcaktohet përndarja e serisë së numrave të ISBN-së te botuesit brenda këtyre grupeve.

SHEMBULLI 1:

ISBN testuese: 9786999999990

Prefiksi EAN.UNCC: 978

(Segmenti testues i grupit): 69999

Grupi (i papërcaktuar dhe i pavlefshëm)

Vërejtje: Ky numër testues i ISBN nuk është i vlefshëm për shkak se segmenti i grupit testues është në kuadër të grupit 65000 deri 69999, që ka një gjatësi të specifikuar grupore prej 0 (që aktualisht është i papërcaktuar).

SHEMBULLI 2:

ISBN testuese: 9780777777770

Prefiksi EAN.UNCC: 978

(Segmenti i grupit testues):07777

Grupi i regjistrimit: 0

Vërejtje: Ky numër testues i ISBN-së është i vlefshëm për shkak se segmenti i grupit testues është në kuadër të serisë 00000 deri 59999, që ka një gjatësi të specifikuar grupore prej 1 (i përcaktuar dhe i vlefshëm).

Tabela 3. ilustron përndarjen e serisë së numrave të elementit të botuesit dhe elementeve të botimit brenda grupit 978-0. Seria e numrave të elementit të botuesit për shfrytëzim në kuadër të secilit grup do të përcaktohet nga Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së në bazë të programit të parashikuar të botimit për atë grup.

Tabela 3.: Përndarja e serisë së numrave të elementit të botuesit dhe elementeve të botimit brenda grupit 978-0

Grupi	Seria e numrave të elementit të botuesit	Numrat në dispozicion të botuesit për identifikimin e botimeve
978-0	00 – 19	1,000,000
	200 – 699	100,000
	7000 – 8499	10,000
	85000 – 89999	1,000
	900000 – 949999	100
	9500000 – 9999999	10

Tabela 4. ilustron se si të përfitohet struktura e brendshme për grupin 978-0. Një ekzaminim i pesë shifrave që e pasojnë elementin e grupit lejojnë përcaktimin e gjatësisë së elementit të botimit. Pasi të dihet gjatësia e elementit të botuesit, mund të përfitohet edhe gjatësia e elementit të botimit.

Tabela 4.: Metoda e përfitimit të strukturës së brendshme për grupin 978-0

Nëse pesë shifrat pas grupit janë midis:	Gjatësia e numrave të botuesit është:	Gjatësia e elementit të botimit është	Ndarjet e brendshme pas secilës prej shifrave në vijim dhe e elementeve shoqëruese:
00000 – 19999	2	6	3-të (prefiks) 4-të (grupi) 6-të (botuesi) 12-të (botimi)
20000 – 69999	3	5	3-të (prefiks) 4-të (grupi) 7-të (botuesi) 12-të (botimi)
70000 – 84999	4	4	3-të (prefiks) 4-të (grupi) 8-të (botuesi) 12-të (botimi)
85000 – 89999	5	3	3-të (prefiks) 4-të (grupi) 9-të (botuesi) 12-të (botimi)
90000 – 94999	6	2	3-të (prefiks) 4-të (grupi) 10-të (botuesi) 12-të (botimi)
95000 – 99999	7	1	3-të (prefiks) 4-të (grupi) 11-të (botuesi) 12-të (botimi)

SHEMBULL:

ISBN testuese: 9780777777770

Prefiksi EAN.UCC: 978

Grupi: 0

(Segmenti testues i botuesit): 7777

Botuesi: 7777

Botimi: 7777

Shifra e kontrollit: 0

Shfaqet ISBN: 978-0-7777-7777-0

Vërejtje: Segmenti testues i botuesit është në kuadër të serisë së numrave 70000 deri 84999, që ka një gjatësi të specifikuar të botuesit prej 4 (i përcaktuar dhe i vlefshëm).

Tabela 5. ilustron përndarjen e serisë së numrave të botuesit dhe maksimumin e botimeve për atë botues brenda grupit 978-951:

Tabela 5.: Përndarja e serisë së numrave të botuesit dhe të botimeve brenda grupit 978-951

Grupi	Seria e numrave të elementit të botuesit	Numrat në dispozicion për botuesin që t'i identifikojë botimet
978-951	0 – 1	100,000
	20– 54	10,000
	550 – 889	1,000
	8900 – 9499	100
	95000 – 99999	10

Tabela 6. ilustron mënyrën e përfitimit të strukturës së brendshme për grupin 978-951. Një ekzaminim i pesë shifrave pas elementit të grupit të botuesit lejon përcaktimin e gjatësisë së elementit të botuesit. Pasi të dihet gjatësia e botuesit, mund të përfitohet edhe gjatësia e elementit të botimit.

Tabela 6.: Metoda e përfitimit të strukturës së brendshme për grupin 978-951

Nëse pesë shifrat pas grupit janë midis:	Gjatësia e elementit të botuesit është:	Gjatësia e elementit të botimit është:	Ndarjet e brendshme do të ndodhin pas secilës shifër pasuese dhe elemente shoqëruese:
00000 – 19999	1	5	3-të (prefiks) 6-të (grupi) 7-të (botuesit) 12-të (botimi)
20000 – 54999	2	4	3-të (prefiks) 6-të (grupi) 8-të (botuesit) 12-të (botimi)
55000 – 88999	3	3	3-të (prefiks) 6-të (grupi) 9-të (botuesit) 12-të (botimi)
89000 – 94999	4	2	3-të (prefiks) 6-të (grupi) 10-të (botuesit) 12-të (botimi)
95000 – 99999	5	1	3-të (prefiks) 6-të (grupi) 11-të (botuesit) 12-të (botimi)

SHEMBULL:

ISBN testuese: 9789512388882

Prefiksi EAN.UCC: 978

Grupi: 951

(Segmenti testues i botuesit): 23888

Botuesi: 23

Botimi: 8888

Shifra e kontrollit: 2

Shfaqet, ISBN: 978-951-23-8888-2

Vërejtje: Segmenti testues i botuesit është në kuadër të serisë së numrave prej 20000 deri 54999, që e ka gjatësinë e specifikuar të botuesit prej 2 (i përcaktuar dhe i vlefshëm).

Katalogimi në botim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

655.4

Doracak i ISBN-së / Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së . - Ribotimi i gjashtë. - Prishtinë : Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, 2013. - 54 f. ; 20 cm

ISBN 978-9951-13-050-9